



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
SEKTORI I FINANCËS

Nr. 304 Prot.

Tiranë, më . 26.02.2021

Drejtuar : **MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MONITORIMIT DHE MENAXHIMIT TË BUXHETIT**

TIRANË

Lënda: **Mbi raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2020**

Në mbështetje të Ligjit nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, dhe në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.07.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr.2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, lutemi gjeni bashkëlidhur Raportin e Monitorimit të Buxhetit të 12-mujorit të vitit 2020 të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Raporti i monitorimit të vitit 2020 krahas analizës së shpenzimeve buxhetore në nivel programi përmban dhe një analizë të objektivave institucionale referuar performancës buxhetore të orientuar drejt rezultateve.

Duke Ju falënderuar për frymën bashkëpunuese,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
(Në mungesë dhe me urdhër)**

Gjovalin PREÇI



PËRMBAJTJA

	Faqe
Hyrje	2
Raport i monitorimit të buxhetit të KLSH-së për vitin 2020	2-3
Analiza e realizimit të buxhetit të KLSH-së për vitin 2020	4-7
Analiza e objektivave institucionale të KLSH-së, referuar buxhetit të orientuar në rezultate.	7-10
Mbi realizimin e objektivave të menaxhimit institucional	10-18
Aneksi Nr. 1 Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve.	19
Aneksi Nr. 2 Raporti i shpenzimeve të Programit sipas artikujve buxhetorë.	20
Aneksi Nr 3 Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës /produkteve të programit.	21
Aneksi Nr. 4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit.	22
Aneksi Nr. 5 Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe të huaj.	23

HYRJJE

KLSH ka kryer monitorimin e buxhetit të 12-mujorit të vitit 2020, nëpërmjet vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të KLSH-së të detajuar në nivel kategori shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar duke mundësuar në këtë mënyrë riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Në vijimësi dhe strukturat respektive të KLSH-së kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetore me qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar dhe të përcaktuar në Deklaratën e politikës së programit të KLSH-së të përfshirë në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022. Në mbështetje të Ligjit nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, dhe në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.07.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr.2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, si dhe të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2020, performanca e realizimit të buxhetit, paraqitet si më poshtë:

PROGRAMI 01120 “VEPRIMTARI AUDITUESE E KLSH-SE”

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtari audituese e KLSH-së”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2020-2023 dhe është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në DPP.

Politika buxhetore e KLSH-së është fokusuar në përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve ligjore, të objektivave si dhe prioriteteve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik, 2018-2022, duke konsideruar kërkesat e organizmave ndërkombëtarë të auditimit dhe të BE-së të përcaktuara në MSA-në e Shqipëri-BE dhe të monitoruara në kuadrin e Integrimit Evropian.

Përgjatë vitit 2020 KLSH vijoi me ushtrimin e veprimtarisë institucionale në përmbushje të objektivave prioritare strategjike të zhvillimit institucional, që konsistojnë në:

- 1. Rritja e impaktit të punës audituese me fokus në 6E-të.***
- 2. Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse.***
- 3. Përmirësimi i kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit.***

Përsa i përket kërkesave buxhetore, duke vlerësuar dhe gjendjen aktuale financiare, menaxhimi i buxhetit është fokusuar në financimin e shpenzimeve në funksion të përmbushjes së objektivave prioritare strategjike që KLSH ka programuar në harkun kohor 2020-2022 në planin strategjik institucional në drejtimet e mëposhtme:

-Fokusi në rritje drejt auditimit të performances, duke synuar rritjen e numrit dhe të kualitetit të auditimeve të performancës, në funksion të arritjes së parametrave të SAI-ve homologe, shtimin e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukture për këtë lloj auditimi, asistimin në formulimin e parametrave të performancës në sektorë të administratës publike etj.

- Kryerja e auditimit financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit (certifikimi i pasqyrave financiare) dhe shtimi i numrit të auditimeve financiare.
- Konsolidimi i Auditimit të Përputhshmërisë vlerësuar sipas kërkesave ISSAI-ve.
- Thëllimi në auditimin e teknologjisë së informacionit shtimi i numrit të auditimeve IT dhe konsolidimi i cilësisë nëpërmjet zbatimit të Standarteve Ndërkombëtare ISSAI.
- Rritjen e performancës së veprimtarisë audituese përmes forcimit të kapaciteteve institucionale të KLSH, duke ruajtur nivelin që KLSH ka konsoliduar tashme përgjatë periudhës 2012-2019,
- Përmirësimin e metodologjive/manualeve të auditimit, duke zhvilluar dhe metodologji të veçanta, si ajo e auditimit të mashtimit financiar, integritetit dhe etikës.
- Nxitja dhe promovimi i vlerave të larta profesionale të audituesve nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve dhe optimizimit të kapaciteteve profesionale.
- Zbatimi i standardeve profesionale nëpërmjet zhvillimit të metodologjive dhe standardeve profesionale të aplikueshme në përputhje me praktikën më të mira të komunitetit të INTOSAI-t.
- Zhvillimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.
- Zhvillimin dhe kualifikimin e burimeve njerëzore konform implementimit të Dokumentit të Politikës së Burimeve Njerëzore në KLSH miratuar me Vendim të Kryetarit nr 128 datë 31.12.2017.
- Rritjen dhe konsolidimin e cilësisë së botimeve me materiale që i shërbejnë procesit të auditimit etj.

“RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS ARTIKUJVE PËR 12/MUJORIN 2020”

Në zbatim të Ligjit 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, është bërë miratimi i çeljes së fondeve buxhetore për vitin 2020, për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në vlerën totale për 444,636 lekë. Plan i përfundimtar i buxhetit të vitit 2020, mbas ndryshimeve gjatë vitit me Akte Normative, ka rezultuar në vlerë 422,312 mijë lekë dhe duke e krahasuar me çeljen e buxhetit, plani përfundimtar është pakësuar për 22.324 mijë lekë, ose me 5% më pak. Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas zërave për 12-mujorin e vitit 2020, paraqiten si më poshtë:

Në mijë lekë

Art.	Përshkrimi i Artikullit	Buxhet i fillestar vjetor	Buxheti i Rishikuar Akti.N 15, 15.04.2020	Buxheti i Rishikuar Akti.N 28, 02.07.2020	Buxheti Faktik 2020	Plan/Fakt	Realizim i në %
1	2	3	4	5	6	5-6	6/5
600	Paga	274,000	270,000	270,000	257,973	12,027	96%
601	Sigurime Shoqërore	42,000	42,000	42,000	40,143	1,857	96%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	80,850	71,850	71,850	50,822	21,028	71%
605	Transferta Korente të Huaja	150	150	150	118	32	79%
606	Trans per Buxh. Fam.	600	2,276	2,276	2,160	116	95%
Totali	Shpenzime Korrente	397,600	386,276	386,276	351,216	35,060	
231	Investime me Financim të Brendshëm	29,000	18,000	18,000	13,763	4,237	76%
231	Investime me Financim të huaj	18,036	18,036	18,036	0	18,036	0%
Totali	Shpenzime Kapitale	47,036	36,036	36,036	13,763	22,273	
Totali	Korrente dhe Kapitale	444,636	422,312	422,312	364,981	57,333	

ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË KLSH-SË PËR 12-MUJORIN E VITIT 2020

Bazuar ne Ligjit 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020" KLSH për vitin 2020 u miratua fondi në total në vlerën 444,636 mijë lekë.

KLSH ndërmori procesin e analizës së buxhetit në kuadrin e situatës së krijuar nga gjendja e fatkeqësisë natyrore për shkak të COVID-19. Ne funksion te kësaj analize u krye *rishikimi i prioriteteve* në drejtim të orientimit të burimeve buxhetore në aktivitetet dhe veprimtaritë më të domosdoshme në kushtet e një regjimi të rreptë të administrimit ekonomik dhe eficient te fondeve te shpenzimeve operative dhe të investimeve për vitin 2020.

Me Vendimin e Kryetarit nr.21, datë 31.03.2020 "Mbi shkurtimin e fondeve te buxhetit te KLSH-se, të shpenzimeve operative dhe të investimeve për vitin 2020 dhe kalimin e tyre ne favor të buxhetit të shtetit për përballimin e situatës se fatkeqësisë natyrore te COVID-19", është vendosur pakësimi i fondeve buxhetore të KLSH-së, si më poshtë vijon:

1. Fondet e investimeve me objekt "Blerje makina" në vlerën prej 9,700 mijë lekë, që përfaqëson 100% të shpenzimeve të planifikuara për këtë zë të investimeve, pakësohen dhe do të kalojnë në favor të buxhetit për përballimin e situatës së fatkeqësisë natyrore COVID-19. Me vendimin e Kryetarit nr. 19, datë 27.03.2020 "Për anulimin dhe pezullimin e procedurave të prokurimeve fondeve për investime dhe operative për vitin 2020, për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID-19" KLSH ka kërkuar anulimin e menjëhershëm të procedurës së prokurimit të fondeve nga Ministria e Brendshme Agjencia e Blerjeve te përqendruara) me objekt prokurimi "Blerje makina" vlere 9,700 mijë lekë.

2. Fondet e investimeve me objekt "Blerje pajisje kompjuterike" në vlerën fillestare prej 7,742 mijë lekë pakësohen në vlerën 1.300 mijë lekë, që përfaqëson rreth 30 % te fondit për këtë zë të investimeve dhe bazuar ne Vendimin e mësipërm u adresua kërkesa AKSHII-t për pezullimin e procedurës së prokurimit.

3. Fondet buxhetore të shpenzimeve operative të mirëmbajtjes pakësohen në vlerën 9,000 mijë lekë ose në 10% të buxhetit vjetor .

Për sa më lart, KLSH adresoi kërkesën për bashkëpunimin me Ministrinë e Financave, për kryerjen e veprimeve për pakësimin e fondeve në favor të buxhetit për përballimin e fatkeqësisë natyrore COVID-19, në shumën totale 24.000 mijë lekë nga të cilat 11 000 mijë lekë në zërin investime që përfaqëson rreth 45% të fondeve të investimeve me financim të brendshëm dhe 9 000 mijë lekë në zërin shpenzime operative ose 10% të totalit të fondeve për këtë zë buxhetor, si dhe 4.000 mijë lekë në zërin Paga dhe sigurimet shoqërore.

A. Shpenzime Korrente

1- Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore. Llogaria 600-601

Fond i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2020 në Ligjin nr.88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", i ndryshuar me Aktin Normativ Nr. 15, datë 15.04.2020 dhe Nr. 28, datë 02.07/2020 për zërin "Shpenzime për paga dhe sigurime", është në vlerën për 312,000 mijë lekë.

Shpenzimet e Personelit janë realizuar në masën 96% pra në vlerë 298,116 mijë lekë kundrejt 312,000 mijë lekë të planifikuara me Aktin Normativ datë 02.07.2020, ose me një mosrealizim në prej 12,027 mijë lekë krahasuar me planin. Krahasuar me planin fillestar shpenzimet janë realizuar në masën 94%. Shuma e shpenzuar në zërin Shpenzime Personeli, përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontaktuar dhe paguar komform shkresave dhe kontratave të nënshkruara me ta.

2- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera. Llogaria 602

Fond i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2020 në Ligjin nr.88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", i ndryshuar me Aktin Normativ Nr. 15, datë 15.04.2020 dhe Nr. 28, datë 02.07.2020 për zërin "Shpenzime operative", është 71.850 mijë lekë.

Shpenzime operative janë realizuar në masën 71% pra në vlerë 50,822 mijë lekë kundrejt 71,850 mijë lekë të planifikuara me Aktin Normativ datë 02.07.2020, ose me një mosrealizim në prej 21,028 mijë lekë krahasuar me planin.

Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve si shpenzime për drita, ujë, telefon etj. Në këtë artikull janë kryer shpenzimet për trajnime jashtë dhe brenda vendit dhe për dieta në funksion të veprimtarisë audituese. Organizimi dhe pjesëmarrja në këto aktivitete janë shoqëruar me kostot përkatëse duke u fokusuar në menaxhimin sa më të kujdesshëm dhe përdorim sa më të efektive të shpenzimeve buxhetore. Një pjesë të konsiderueshme në shpenzimet operative e zënë shpenzimet për udhëtim e dieta brenda vendit. Në kuadrin e pakësimeve të bëra në kuadrin e fatkeqësisë natyrore Covid u ndërmor procesi i detajimit të fondeve të shpenzimeve për Mallra dhe Shërbime të Tjera (zërit 602) duke analizuar kostimin e shpenzimeve.

Në mijë lekë

Artikulli	Përshkrimi i Artikullit	
6020	Materiale zyre dhe të përgjithshme	1,355
6022	Shërbime nga të tjerë	9,318
6023	Shpenzime Transporti	1,417
60241	Udhëtim i brendshëm/Dieta	34,300
60242	Udhëtim jashtë shteti/Dieta	1,921
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	2,286
6029	Shpenzime të tjera operative	225
Total artikulli 602		50,822

3- Transferta korrente dhe të huaja. Llogaria 605

Gjatë periudhës raportuese janar-gusht 2020, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAT, në shumën 117 mijë lekë nga 150, mijë lekë të planifikuara.

4- Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606

Gjatë periudhës janar-gusht 2020, është dhënë Fond i Veçantë me kërkesat e bëra nga ana jonë dhe të konfirmuara nga Ministria e Financave në vlerën 2.276 mijë lekë, për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie dhe sëmundjeje dhe është realizuar në masën 2,160 mijë lekë.

5- Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 231

Fond i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2020 në Ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar me Aktin Normativ Nr. 15, datë 15.04.2020 dhe Nr. 28, datë 02.07/2020 për zërin “Shpenzime për Investime”, është në vlerën për 36,036 mijë lekë nga të cilat 18,000 mijë lekë investime me Financim të Brendshëm.

B. Shpenzime për Investime Kapitale

1-Financim i Brendshëm

Me Aktin Normativ nr.15, datë 15.04.2020, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale u pakësua në vlerën prej 11.000 mijë lekë.

Në mijë lekë

Kod. P	Emërtimi i Projektit	Buxheti fillestar vjetor	Buxheti i Rishikuar Akti.N 15, 15.04.2020	Buxheti Faktik 2020	Diferenca	Realizimi
M240009	Blerje automjete	9,700	0	0	0	0
M240010	Blerje pajisje kompjuterike	16,880	15,580	13,493	2,087	87%
M240011	Pajisje të ndryshme zyre	520	520	271	249	52%
M240012	Kosto lokale	1,900	1,900		1,900	0%
Investimeve me F. të Brendshëm		29,000	18,000	13,764	4,236	

-Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit në blerje “**Automjete**”, për automjete në vlerën 9,700 mijë lekë. KLSH anuloi kryerjen e procedurave të prokurimit. Ky fond është pakësuar në bazë të Aktit Normativ nr.15, datë 15.04.2020 referuar pakësimeve të kryera nga KLSH për shkak të situatës Covid-19.

-Blerje **Pajisje kompjuterike**. Për vitin 2020, është kryer shpenzimi në vlerën 13.493 mijë lekë nga 15,580 mijë lekë të planifikuara me Aktin Normativ nr.15, datë 15.04.2020, për pajisje kompjuterike me qëllim rritjen e sigurisë së sistemeve teknologjike të institucionit. Në saj investimeve të alokuara për infrastrukturën IT, kjo e fundit u plotësua dhe u zhvillua duke zgjeruar kapacitetet e pajisjeve ekzistuese si dhe duke shtuar në ambientin teknologjik të KLSH-së pajisje që shërbejnë për rritjen e sigurisë së informacionit (Email Security Gateëay dhe Next Generation Fireëall). Instalimi dhe implementimi i pajisjeve tashmë është i përfunduar. Si rezultat i këtyre investimeve tanimë është rritur siguria e TI në drejtim të shkëmbimit të informacionit përmes postës elektronike, mbrojtjes nga programet dashakeqe (virese, malëare, spyëare etj.) si dhe ofrohet një pasqyrë më e qartë e rrjetit netëork të KLSH me qëllim optimizimin e tij dhe garantimin e disponibilitetit, integritetit dhe konfidencialitetit të informacionit.

-Blerje **Pajisje zyrash**, fondi i planifikuar në këtë zë është 520 mijë lekë. Për vitin 2020, në këtë zë janë kryer shpenzime në masën 271 mijë leke, për blerjen e paisjeve të ndryshme për zyrat.

2-Financim i Huaj

Artikulli	Përshkrimi i Artikullit	Buxheti fillestar vjetor	Në mijë lek		
			Buxheti i Rishikuar Akti.N 15, 15.04.2020	Buxheti i Rishikuar Akti.N 28, 02.07.2020	Buxheti Faktik 2020
230	Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm	18,036	18,036	18,036	0

Në artikullin 230 “**Shpenzime kapitale të patrupëzuara të huaja**” për vitin 2020, është parashikuar investime për zbatimin e projektit, “Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikëqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri”. Projekti “Forcimi i kapaciteteve në auditimin e prokurimeve publike, koncesioneve dhe PPP-ve” është përgatitur nga KLSH qysh në vitin 2016, si pjesë e aplikimit për mbështetje nga INTOSAI - IDI Donor Cooperation.

Projekti u shpall fitues nga IDI, të cilët e referuan propozimin tek Banka Botërore nën Programin SAFE, por për shkak të numrit të lartë të aplikimeve KLSH-së iu sugjerua kontaktimi me zyrën e SECO (Sëiss State Secretariat for Economic Affairs).

Pas takimeve dy palëshe të realizuara kryesisht gjatë fundvitit 2019, u dakordësua për financimin e projektit në shumen totale **240 mijë CHF**, prej të cilave 220'000 CHF, janë financim i SECO dhe 22 000 CFH (10% e vlerës) financim nga buxheti i shtetit për KLSH-në. Projekti do të ketë një kohë CHF, zgjatje 2 vjeçare dhe marrëveshja për fillimin e tij u nënshkrua në ambientet e KLSH-së, në datën 9 mars 2020 .

Qëllimi kryesor i projektit është rritja e kontributit të KLSH-së për të forcuar llogaridhënien geveritare në përdorimin e fondeve publike përmes auditimeve më profesionale dhe gjithëpërfshirëse të prokurimeve publike, koncesioneve dhe partneriteteve publike-private, duke përdorur mjete IT në kryerjen e auditimeve financiare, përputhshmërisë dhe performancës në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikën e mira profesionale për sektorin publik. Objektivi i përgjithshëm i projektit është të nxisë mbikëqyrjen publike dhe të rrisë cilësinë, transparencën dhe frenimin e korrupsionit në ofertat publike, koncesionet dhe partneritetet publike-private (PPP). Ky projekt do të bëjë të mundur krijimin e eksperiencave të reja dhe do të përsosë njohuritë dhe aftësitë e audituesve të KLSH-së për të mbikëqyrur fushën e koncesioneve dhe kontratave të partneritetit publik-privat duke sjellë dhe plotësimin e një kornize të përshtatshme për të siguruar që këto lloj kontratash ofrojnë vlerë të shtuar dhe minimizojnë risqet në kushtet e financimit publik. I

gjithë ky proces nuk mund të bëhet pa garantuar që audituesit kanë aftësitë e duhura teknike lidhur me përdorimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit në auditim. Projekti do të mundësojë auditime më cilësore dhe do të japë rekomandime me vlerë të shtuar në mirë menaxhimin e kontratave të PPP-ve, duke përmirësuar dhe kuadrin ligjor të realizimit të tenderave publike përkatës dhe të lidhjes dhe zbatimit të kontratave koncesionare. Ky projekt dy vjeçar do të ndihmojë dukshëm në drejtim të auditimit më profesional të fondeve publike në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve në Shqipëri. Bashkëpunimi mes KLSH-së dhe Sekretariatit të Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) i Konfederatës zvicerane do të mbështesë ngritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH-së, por do të jetë njëkohësisht edhe promotori i mbështetjes së Konfederatës së Zvicrës për Republikën e Shqipërinë.

ANALIZA E OBJEKTIVAVE INSTITUCIONALE TË KLSH-SË, REFERUAR BUXHETIT TË ORIENTUAR NË REZULTATE PER VITIN 2020

KLSH përgjatë vitit 2020 vijoi veprimtarinë menaxheriale institucionale suportuar nga një qeverisje e brendshme efektive dhe mirëfunksionimi të sistemeve të kontrollit të brendshëm duke siguruar përputhshmërinë me standardet e kontrollit të brendshëm me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përmbushjen e objektivave Strategjike në nivelin e pritshmërive të synuara drejt konsolidimit të reformave të ndërmarra, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI, me rekomandimet e Progres Raportëve të BE, me detyrimet kushtetuese dhe me pritshmëritë e Kuvendit, publikut dhe të gjitha palëve të interesit.

1. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E KLSH-së

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në katër nene të saj ka qartësisht të shprehur misionin dhe nivelin pavarësisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat formëzojnë identitetin institucional të tij. Ky mision dhe funksionimi institucional janë strukturuar dhe sanksionuar në detaje në Ligjin nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, mbi bazën e të cilave janë ndërtuar të gjitha aktet rregullative institucionale dhe metodologjike të institucionit.

Misioni i KLSH-së

KLSH është institucion i pavarur kushtetues, i ndërtuar që ti shërbejë qytetarit shqiptar, të jetë “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Në përmbushje të kërkesave ligjore, standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe të institucioneve supreme të auditimit të INTOSAI-t dhe EUROSAT-t si dhe akteve rregullatorë, KLSH kryen auditime financiare, të përputhshmërisë, të rregullshmërisë, të performancës, të teknologjisë së informacionit, si edhe ndërmerr vlerësime të sistemit të menaxhimit financiar e kontrollit dhe njësisë të auditimit të brendshëm të strukturave qeverisëse dhe ente të tjera publike. KLSH ka funksionuar do të vazhdojë të veprojë si një agjent ndryshimi, në shërbim të qytetarit dhe të qeverisjes së mirë, duke reflektuar vlerat dhe parimet e një SAI modern, anëtar i komunitetit të INTOSAI-t i udhëhequr nga motoja “*Të gjithë të bashkuar në ambicie dhe vendosmëri*”

Vizioni shkon përtej qasjes tradicionale të fokusuar në vlerësime dhe konstatime. Audituesit e jashtëm publikë e realizojnë aktivitetin e tyre jo vetëm duke vepruar por duke bashkëvepruar nëpërmjet rekomandimeve dhe këshillimeve të subjekteve publike të audituara për të maksimizuar vlerën e parasë publike.

Vizioni i KLSH-së

KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të pasurisë publike, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni, për të qenë vlerë e shtuar për shoqërinë dhe të sjellë ndryshim në jetën e qytetarëve.

Misioni dhe vizioni orientojnë mënyrën sesi institucioni duhet të performojë për të: garantuar përgjegjshmërinë, transparencën dhe integritetin e qeverisë dhe njësisë të tjera të sektorit publik; nxitur llogaridhënien para Parlamentit dhe rritur transparencën për qytetarët; duke qenë një organizatë model që udhëheq nëpërmjet shembullit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, përmbush misionin dhe realizon veprimtarinë në zbatim të tetë parimeve: Pavarësia; Profesionalizmi; Bashkëpunimi; Përgjegjshmëria; Bashkëpunimi; Përgjegjshmëria; Integriteti; Objektiviteti; Interesi Publik; Transparenca

Zhvillimi i KLSH mbështetet në Strategjinë Afatmesme të Zhvillimit të Institucionit të miratuar nga Kryetari KLSH, për periudhën 2018-2022. Në këtë strategji KLSH ka përcaktuar Misionin dhe vizionin institucional të së ardhmes. Objektivi i ISSAI-t 12, sipas të cilit “*SAI duhet të jetë një organizatë model që udhëheq nëpërmjet shembullit*”, përbën boshtin mbi të cilin është hartuar Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së dhe që synon të sigurojë: transparencën dhe përgjegjshmërinë e duhur; qeverisjen e mirë; pajtueshmërinë me Kodin e Etikës; ndërtimin e kapaciteteve nëpërmjet promovimit të të mësuarit dhe shpërndarjes së njohurive.

Kështu, për qëllimin e parë strategjik “*Rritja e impaktit të punës audituese me fokus 6E-të*” janë përcaktuar si objektiva:

- Forcimi i pavarësisë dhe mandatit të KLSH;
- Auditimi mbi bazë risku – qasje efektive e auditimit;
- Kryerja e auditimit financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit;
- Fokusi në rritje drejt auditimit të performancës;
- Thellimi në auditimin e Teknologjisë së Informacionit;
- Konsolidimi i auditimit të përputhshmërisë vlerësuar sipas kërkesat e ISSAI-ve
- Cilësia si prioritet i KLSH - përmirësimi i cilësisë dhe përfitimi nga auditimet e KLSH;
- Forcimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, rritja e nivelit të rekomandimeve të pranuara dhe të zbatuara;
- Rritja e impaktit të raportimeve nëpërmjet rritjes së përdoruesve të produkteve të KLSH-së; dhe
- Roli i KLSH-së në luftën kundër korrupsionit.

Qëllimi i dytë strategjik “*Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese: procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse*” ka si objektiva:

- Korniza e Matjes së Performancës - si mjet vlerësimi dhe faktor zhvillimi të veprimtarisë së KLSH-së;
- Zbatimi i standardeve profesionale nëpërmjet zhvillimit të metodologjive dhe standardeve të aplikueshme në përputhje me praktikën më të mira të profesionit;
- Nxitja dhe promovimi i vlerave të larta profesionale të audituesve nëpërmjet kultivimit të kulturës të të mësuarit gjatë gjithë jetës;

- Forcimi i sistemit të strukturuar të edukimit profesional nëpërmjet certifikimit të audituesve publikë dhe zhvillimit të vazhdueshëm;
- Implementimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i dokumentit të politikave të burimeve njerëzore të KLSH-së.
- Integriteti si vlerë themelore
- Forcimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.

Për qëllimin e tretë strategjik *“Përmirësimi i kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit”* është përcaktuar realizimi i objektivave;

- Konsolidimi i marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin;
- Roli i KLSH në axhendën e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm
- Implementimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i Strategjisë për komunikim të KLSH-së;
- Thellimi dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucionet e tjera.

Objektiv i vazhdueshëm i *KLSH-së* është të jetë një faktor profesional aktiv dhe partnere për fuqizimin e mirëqeverisjes financiare dhe llogaridhënies publike në funksion të promovimit të transparencës, eficiencës dhe efektivitetit. Në këtë kuadër thellimi i luftës kundër korrupsionit është në fokus të veprimtarisë institucionale.

Edhe gjatë vitit 2020, objektivat institucionale ne te cilin fokuson aktivitetin KLSH-së, konsistojnë në:

- Sfida për orientimin e auditimit bazuar në riskun e gabimeve, mashtrimit dhe korrupsionit është adresuar nëpërmjet zhvillimeve dhe përmirësimeve të metodologjisë, duke u përqendruar në auditimin e sektorëve të ekonomisë me ekspozim më të lartë ndaj këtyre risqeve.
- Konsolidimi dhe rritja e numrit të auditimeve të performancës përmes zgjerimit të temave të fokusimit dhe të rritjes graduale të kapaciteteve profesionale dhe numerike të departamentit.
- Zhvillimi dhe rritja e numrit të auditimeve financiare, dhënia e opinionit për pasqyrat financiare si një hap më tej drejt përmbushjes së objektivit për rritjen e numrit të auditimeve financiare.
- Konsolidimi dhe modernizimi i qasjes për auditimet e përputhshmërisë në të njëjtën linjë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.
- Rritja e cilësisë dhe e numrit të auditimeve IT, si dhe zhvillimi i kapaciteteve të auditimit IT.
- Rritja e besueshmërisë tek institucioni suprem i auditimit, vlerësuar nga perceptimi i qytetarëve është një tregues se auditimet dhe raportimet janë kryer me integritet dhe profesionalizëm të lartë, etj.

-Mbi Menaxhimin e Riskut në funksion të arritjes së objektivave përgjatë periudhës Covid-19

Një qasje konstruktive e menaxhimit të riskut institucional e prezantuar si një nevojë imediate menaxheriale është aplikuar referuar situatës së fatkeqësisë natyrore Covid -19 ku institucioni u përball dhe vijon të përballët me një sere risqesh të cilat kërcënojnë arritjen e objektivave.

Me qëllim mitigimin, zbutjen, minimizimin e risqeve Kryetari i KLSH-së adresoi për zbatim një platforme programatike për sigurimin e funksionimit të institucionit dhe të sigurimit të vazhdimësisë së veprimtarisë nëpërmjet pjesëmarrjes proaktive të cdo punonjësi në KLSH. Kjo u arrit nëpërmjet udhëheqjes menaxheriale nga Kryetari duke adresuar akte administrative, si urdhra vendime apo orientime dhe ftese për pjesëmarrje për angazhimin e të gjithë stafit në aspektet e kryerjes së veprimtarive online sikurse janë:

- Vijimi i veprimtarisë audituese,
- Ndjekjes së platformës së trajnimeve online
- Kryerjes së testeve,


- Zgjerimit të njohurive profesionale audituese (por jo vetëm),
- Dhënies së mundësisë të çdo anëtarit të stafit të KLSH-se të paraqesë ide apo platforma për zhvillimin dhe progresin institucional,
- Ngritja e grupeve të punës për përditësimin e përmirësimin e manualeve të auditimit të i) performancës, ii) financiar, të iii) buxhetit iv) përputhshmërisë të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dhe hartimit të regjistrit institucional IT të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve
- Dhe drejtime të tjera të veprimtarisë menaxheriale.

Mbi veprimtarinë audituese të KLSH -së për vitin 2020

Për periudhën janar-dhjetor 2020, Kontrolli i Lartë i Shtetit, nga 143 auditime të planifikuara për auditim ka evaduar 73, si dhe ka ushtruar dhe ka vijuar me përgatitjen e materialeve për 145 auditime.

73 misionet e auditimit të evaduara janë detajuar si më poshtë:

- 28 auditime përputhshmerie
- 16 auditime përputhshmërie dhe financiare¹
- 9 auditime performance
- 5 auditime financiare
- 4 auditime IT
- 11 auditime tematike



Puna audituese është përqendruar kryesisht në fushat për të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vlerësuar një nivel të lartë risku. Edhe gjatë kësaj periudhe, shkeljet më të mëdha me efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit dhe jo vetëm, lidhen me administrimin e të ardhurave: menaxhimin jo të kujdesshëm në procesin e përdorimit të fondeve publike; keq administrimin e pronës shtetërore ndjekur nga paligjshmëritë procedurale dhe ineficencat në realizimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe shkeljet në zbatimin e legjislacionit fiskal. Duhet theksuar se me impakt janë edhe shkeljet e lidhura me shkeljet në programimin, implementimin dhe zbatimin e kuadrit fiskal. Këto shkelje financiare përgjithësisht i përkasin veprimtarisë ekonomiko-financiare për periudhën kohore 2017-2019 përcaktuar për çdo subjekt të audituar në programet e auditimit.



Institucionet ku janë ushtruar misionet e auditimit

Auditimet janë kryer në 89 subjekte. Auditimet janë shtrirë në institucione qendrore dhe njësi të varësisë për të patur një mbulim të kënaqshëm dhe për të garantuar një sistem menaxhimi financiar dhe kontrolli sa më efektiv. Këtu përfshihen ministrat dhe agjencitë (drejtori qendrore dhe rajonale) në varësi të tyre, organet e sistemit fiskal, shoqëritë aksionere me kapital shtetëror, në të cilën shteti ka mbi 50% të aksioneve, njësi të vetëqeverisjes vendore (qarqe, bashki, komuna) si dhe projekte me financim të huaj, duke mbuluar të gjithë ciklin e veprimtarisë së tyre (të ardhurat dhe shpenzimet).


Tabela nr.1 Institucionet ku janë ushtruar misionet e auditimit

Auditimet e KLSH-së janë ushtruar në këto institucione:	Nr
☞ Institucione të qeverisjes qendrore	14
☞ Institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	18
☞ Institucione të tjera financiare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe institucionet vartëse financiare	10

¹ Në 16 auditimet e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë klasifikuar si auditime mikse janë dhënë opinione për pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë për 11 auditime.

☞ Shogëritë publike dhe projektet me financim të huaj	9
☞ Institucionet e administrimit të aseteve dhe mbrojtjes së mjedisit	8
☞ Institucionet në të cilat janë kryer auditimet IT	4
☞ Institucionet në të cilat janë kryer auditimet e Performances	26
TOTALI I SUBJEKTEVE	89

Grafik nr.1 Subjektet e audituara në periudhën Janar – Dhjetor 2020



Burimi KLSH

Trajtimi i Letrave të qytetarëve

Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020 ka vijuar të trajtojë me korrektesë dhe profesionalizëm letrat dhe ankesat e qytetarëve, të cilët në çdo rast kanë marrë përgjigje, edhe kur çështja e ngritur prej tyre ka qenë jashtë kompetencave të institucionit, duke i orientuar qytetarët, nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet ti drejtohen për të marrë përgjigje për shqetësimet e tyre.


Përgjatë kësaj periudhe KLSH ka trajtuar 301 letra dhe ankesa, nga të cilat 80 jashtë kompetencës dhe juridiksionit të institucionit. Nga 221 ankesa në kompetencë të KLSH, 136 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigje, ndërsa 85 janë në proces verifikimi.

Trajtimi i kërkesave për të drejtën e informimit

E drejta e informimit si një e drejtë kushtetuese dhe tani e parashikuar qartazi në një legjislacion të veçantë, është e drejtë elementare e çdo individi në një shoqëri demokratike. Që me miratimin e ligji të ri nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka pasur një numër në rritje kërkesash për informacion nga viti në vit, të ardhura nga individë, subjekte të ndryshme dhe OJF. Vetëm gjatë periudhës janar – dhjetor 2020 janë trajtuar dhe u është përcjellë informacioni i kërkuar 38 kërkesave, të ardhura në adresën e koordinatorsit të informimit të KLSH-së.

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohen fushat kryesore të shqetësimit publik për çështje të qeverisjes në Shqipëri, nga të cilat 9% e ankesave të adresuara KLSH-së i takojnë administrimit financiar dhe fushës së prokurimit publik; 3% në fushën e taksave, tatimeve, 61% administrimit dhe kthimit të pronës dhe 16% fushave të tjera dhe 11% trajtojnë çështje të ndryshme.

Grafik nr. 2 Fushat kryesore të shqetësimit publik



Burimi KLSH

Mbi trajnimet e realizuara gjatë vitit 2020.

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Jashtëm të INTOSAI-t, ISSAI 100, Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit Administrativ të KLSH, në zbatim të Programit të Zhvillimit Profesional të KLSH për vitin 2020, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH 187, datë 31.12. 2019, gjatë kësaj periudhe edhe pse në kushte jo normale për shkak të Pandemisë Covit-19, KLSH ka realizuar një sërë trajnimesh, kryesisht brenda institucionit, të fokusuar në Standardet e auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualët e auditimit si dhe në udhëzues specifikë, si më poshtë:

Tabela nr. 6 “Trajnimet 2020, sipas aktiviteteve”

Nr.	Tema trajnimit	Periudha	Organizues	Ditë
1	Konferenca 100 vjet NIK .	Janar	KLSH	1
2	Konferenca mbi aktivitetet e zhvilluara jashtë vendit, në vitin 2018.	Janar	KLSH	1
3	Trajnim Departamenti i Institucioneve Qendrore, mbi: - Sigurimin e cilësisë në auditim; - Auditimin financiar - Prokurimet publike	Janar	KLSH	4
4	Trajnim Departamenti i IT-së, mbi: - Auditimi IT në MFE; - Mbi Manualin e auditimit IT - Cikli i jetës së një sistemi - Analiza dhe Vizualizimi i të dhënave		KLSH	4
5	Analiza vjetore 2019 në nivel departamenti.	Janar-Shkurt	KLSH	4
6	Analiza vjetore e performancës së KLSH për vitin 2019.	Shkurt	KLSH	2
7	Trajnim me audituesit e rinj, mbi auditimi e jashtëm publik dhe kuadrin ligjor të KLSH-së.	Shkurt	KLSH	5
8	Intosaint ëorkshop.	Shkurt	KLSH	3
9	Trajnim online, gjatë karantinimit.	Mars-Prill	KLSH	18
10	Trajnimi IDEA.	Maj-Qershor	KLSH	18
11	Trajnim për aftësim në komunikim, në reformën për MFP-e.	Korrik	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	3
12	Trajnim mbi Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH. Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore	Korrik	KLSH	5
13	Trajnim mbi Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH. Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Financimit të Huaj dhe Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit	Gusht	KLSH	5
14	Trajnim mbi Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH.	Gusht-	KLSH	5

	Performanca dhe IT	Shtator		
15	Ëorkshop me Organizatën Jofitimprurëse “Qëndresa Qytetare”	Tetor	KLSH	1
16	Trajnim mbi Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë.	Nëntor	KLSH	7
17	Trajnim mbi Manualin e Auditimit të Performancës	Nëntor	KLSH	3
18	Trajnim mbi Manualin e Auditimit Financiar	Nëntor	KLSH	3
19	Trajnim i Përbashkët me Ministrinë e Financave, mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm dhe auditin e brendshëm në sektorin publik.	Nëntor	KLSH	2
20	Trajnim mbi Udhëzuesin e menaxhimit të cilësisë së auditimeve në KLSH.	Dhjetor	KLSH	2
21	Trajnim mbi Manualin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.	Dhjetor	KLSH	15
22	Totali ditë aktiviteti			93
	Aktivitete nga SAI homologe/ organizata të tjera			
1	Seminari i 7-të ndërkombëtar mbi integritetin i organizuar nga SAI i Hungarisë	Shkurt	Hungari	4
2	Vizitë e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në SHBA	Shkurt	SHBA	10
3	Konferenca e ZKA të Kosovës	Shkurt	Kosovë	1
4	Aktiviteti i SAI-t, të Malit të Zi “Për marrëdhëniet SAI-Parlament”	Shkurt	Mal i Zi	3
5	Takimi i parë mbi inovacionin (Hackathon i Parë), Pragë-Çeki	Mars	Pragë-Çeki	3
6	Takim “Self assesment Project Group i ITASA”	Mars	Bernë-Zvicër	2
7	Seminar i Zhvilluar online, “Energjia e qendrueshme”	Prill	Online	2
8	Ëëbinar-e online. Anti-korrupsioni dhe Integriteti	Maj	Online	1
9	Ëëbinar i EUROSAL, “Për auditimin e çështjeve që lidhen me pandeminë Covid-19”	Qershor	Online	1
10	Konferenca e përbashkët të EOROSAL-OLACEFS	Shtator	Online	3
11	EUROSAL, ËGEA	Shtator	Online	3
12	Non financial reporting (NFR) and integrated Reporting (IR) in Public Sector	Shtator	Online	1
13	Aktiviteti i CEF, “Mbi buxhetimin”	Tetor	Online	1
14	Takim i ITËG	Nëntor	Online	1
15	Takim i Grupit IT-GAO	Nëntor	Online	1
16	Takim i TFMA	Nëntor	Online	1
17	Takim NATO	Nëntor	Online	1
18	Takim i grupit të EUROSAL, “Për klimën”	Nëntor	Online	1
19	Takim i Grupit të punës “Për katastrofat”	Nëntor	Online	2
20	Ëorkshop SIGMA, “Për masat anti Covid-19”	Dhjetor	Online	1
	Totali ditë aktiviteti			43

Sa më sipër, gjatë vitit 2020, janë zhvilluar 21 aktivitete brenda vendit dhe të organizuara nga KLSH, të shtrira në 93 ditë, si dhe 20 aktivitete të zhvilluara jashtë vendit, ose të organizuara nga institucione/organizata jashtë vendit.

Tabela nr. 7 “Trajnime me programe të veçanta”

Nr.	Trajnime me programe të veçanta	Vendimet e miratimit
1.	Analiza vjetore të veprimtarisë së Departamenteve të KLSH-së, për vitin 2019, 28-31 Janar, 2020.	Miraturar me Urdhër nr. 6, datë 23.01.2020
2.	Analiza vjetore e performances së KLSH për vitin 2019, nga data 28 -29 Shkurt 2020.	Miraturar me Urdhër nr. 6, datë 23.01.2020 Seria: Botime KLSH 07/2020/120; Publikuar në ËEB: ëëë.klsh.org.al, KLSH Analiza Vjetore 2019
3.	Program trajnimi për Audituesit e rinj, “Prezantimi me Auditimin e Jashtëm Publik dhe KLSH-në”, 10-15 Shkurt 2020.	Miraturar me Vendimin nr.187, datë 31.12.2019, sipas të cilit të gjithë audituesit e sapo rekrutuar në KLSH gjatë vitit 2020, duhet të ndjekin programin e trajnimit për audituesit e rinj.
4.	Trajnimi IDEA, për auditues të rinj, me përvojë pune deri	Miraturar me Vendimin nr. 407, datë

në 3-vjet në KLSH, zhvilluar në Maj-Qershor 2020.	30.04.2020.
5. Platformë Trajnimi në distancë (online) 16 Mars - 16 Prill 2020	Miratur me Vendimin m.145/3, datë 16.03.2020
6. Program trajnimi (online), mbi rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, 15 Korrik -30 Gusht, 2020.	Miratur nga kryetari KLSH-së me nr.724 prot datë 24.07.2020
7. Program trajnimi për periudhën 04.11.2020-28.12.2020, mbi manualin, trajnimet e përbashkëta me MFE dhe Udhëzuesin e cilësisë	Miratur me Vendimin nr. 724/1, datë 09.11.2020.

Për shkak të përballjes globale me Pandeminë Covid-19, si të gjithë institucionet e tjera, edhe KLSH, në zbatim të rregullave dhe akteve ligjore, të dala për menaxhimin e situatës së pandemisë, hartoi rregulla dhe mënyra të reja për realizimin e objektivave të saj.

Nisur nga krijimi i kësaj situate, Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit, pati një qasje të re në realizimin e trajnimeve duke u fokusuar në realizimin e tyre nëpërmjet platformave online. Trajnimet në KLSH, janë realizuar nëpërmjet platformës “Microsoft Skype” për realizimin e komunikimit online me audio dhe video, bazuar në përcaktimet e Udhëzimit të Drejtorisë IT nr. 2, datë 04.05.2020 “Mbi përdorimin e mjeteve teknologjike për zhvillimin e komunikimit online përgjatë periudhës së pandemisë”.

Gjatë këtij viti, u realizuan disa tema trajnimi online, nga të cilat, në tre prej tyre pati përfshirje të të gjithë audituesve, konkretisht:

1. Në periudhën e karantinimit, Mars-Prill 2020, u zhvilluan 15 tema trajnimi, të konceptuara në formën e kazuseve, ku secili nga audituesit ka dhënë zgjidhjet e veta. Temat e punuara nga secili audites, janë ngarkuar në sistemin RevZone.
2. Në periudhën Korrik-Gusht 2020, u zhvilluan trajnime me të gjithë audituesit e KLSH-së, sipas departamenteve, me temë mbi përditësimin e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH;
3. Në periudhën Nëntor-Dhjetor 2020, u zhvilluan trajnime me të gjithë audituesit e KLSH-së, mbi përditësimet e manualeve të auditimit, mbi Manualin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, si dhe mbi Udhëzuesin e Menaxhimit të Cilësisë.

Planifikimi i detajuar dhe realizimi i tyre u krye bazuar në:

1. Për periudhën e fatkeqësisë natyrore COVID-19 ka vijuar trajnimi i audituesve në distancë, sipas programit të **miratur me nr. 145/3, datë 16.03.2020**, ku përfshihen katër javë trajnim në distancë.

Përgjatë periudhës 4-javore **16 mars-16 Prill 2020**, nga gjithë audituesit e KLSH-së, është zbatuar dhe avancuar teknika e edukimit në distancë, ose Trajnimi Online, në kushtet që audituesit nuk janë të pranishëm fizikisht në auditor apo salla leksionesh, diktuar dhe kushtëzuar nga situata e jashtëzakonshme e pandemisë globale, Covid-19.

Trajnimi i periudhës 16 mars - 16 prill 2020 u krye dhe organizua nëpërmjet ndarjes së stafit të audituesve të KLSH në 4 grupe si vijon:

1. **Grupi i parë:** audituesit me formim akademik në financë, kontabilitet, ekonomi, administrim biznesi etj.
2. **Grupi i dytë:** audituesit me formim akademik në shkencat inxhinierike, juridik, shkenca sociale etj.
3. **Grupi i tretë:** audituesit e Departamentit të Auditimit të Performancës,
4. **Grupi i katërt:** audituesit e Departamentit të Auditimit të IT-së.

Hedhja në Revzone e ecurisë së ndjekjes së trajnimeve të zhvilluara nga çdo auditues (Matrica e ndjekjes së ecurisë Mars-Prill 2020), Informacioni i plotë mbi trajnimet (Raport Progreset javore dhe të përditësuara); postimi i fondit të testeve, pyetjeve, ushtrimeve dhe rasteve studimore, etj.

Audienca e synuar: gjithë audituesit nga departamentet e auditimit apo drejtoritë e tjera në institucionin e KLSH-së, janë përfshirë si pjesë e studimit në këtë paketë studimi inovativ të çështjeve nëpërmjet internetit, ku audituesve iu kërkua të konceptojnë dhe formulojnë opinionet, përgjigjet dhe zgjidhjet mbi një nomenklaturë të gjetjeve apo rekomandimeve në një mjedis të simuluar të auditimit, në funksion të zbërthimit e shtjellimit të çështjeve që rrjedhin nga literatura që është ofruar më parë.

2. Sipas Programit të Trajnimit nr. 724, datë 24.07.2020, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe kalendarit pjesë e tij, janë zhvilluar trajnimet si më poshtë:

Pas finalizimit të procesit të rishikimit të Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, si nevojë e pasqyrit të ndryshimeve të ISSAI dhe Manualeve të auditimit në KLSH, si dhe rekomandimeve të ekspertëve të NIK Polak (Projekti IPA-2013), të miratuar me Vendimin nr. 63, datë 22.06.2020, u kryen trajnimet e mëposhtme:

Tabela nr. 8 “Kalendar i trajnimeve dhe realizimi i tyre”

Tema: Rregullore e procedurave

Nr.	Departamentet/Strukturat pjesëmarrëse	Afatet	Statusi
I	Departamenti i Auditimit të vetëqeverisjes Vendore	27-30.07.2020	Realizuar
II	Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore	27.30.07.2020	Realizuar
III	Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit	03.07.08.2020	Realizuar
IV	Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja	03-07.08.2020	Realizuar
V	Departamenti i Auditimit të Performancës	26-28.08.2020 01-02.09.2020	Realizuar
VI	Departamenti i Auditimit IT		Realizuar
VII	Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit	-	Pa realizuar

Trajnimit mbi Rregulloren e procedurave të auditimit në KLSH, u zhvillua për 5 ditë, duke trajtuar, Fazën e planifikimit, Fazën e Auditimit në terren, Fazën e Raportimit, bazën ligjore ndryshimet e ISSAI-ve dhe opinionet përkatëse të auditimit, sipas llojeve të auditimit.

Trajnimet u kryen në bazë departamentale, si dhe duke kombinuar studimin e pavaruar të rregullores, si dhe trajtimin më pas të fazave të auditimit dhe diskutimin e çështjeve të nevojshme, në platformën online. Referuar Programit të Trajnimeve dhe Kalendarit bashkëngjitur, nuk është realizuar trajnimi mbi Rregulloren e Procedurave të Auditimit me Departamentin e Auditimit të Buxhetit, për faktin se përkonte me periudhën e hartimit të Raportit të Buxhetit të vitit 2019, si dhe më pas me fillimin e trajnimeve mbi manualët e auditimit. Ky trajnim do të realizohet gjatë vitit 2021.

3. Sipas Programit të Trajnimit, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 724/1, datë 09.11.2020, mbi përditësimet e manualeve të auditimit, u zhvilluan trajnimet e mëposhtme:

Tabela nr. 10 “Kalendar i trajnimeve dhe realizimi i tyre”

Nr.	Tema e trajnimeve	Departamentet/Strukturat pjesëmarrëse	Afatet
I	Manuali i Auditimit të	Departamentet e auditimit	10-17.11.2020

	Përputhshmërisë		
II	Manuali i Auditimit të Performancës	Departamenti i Auditimit të Performancës dhe nga dy auditues për çdo departament auditimi	18-20.11.2020
III	Manuali i Auditimit Financiar	Audituesit me profil Financë-Kontabilitet nga çdo departament	23-25.11.2020
IV	Trajnim i përbashkët me Ministrinë e Financave mbi KBFP & MFK	Nga një përfaqësues për çdo departament	26-27.11.2020
V	Udhëzuesi i Menaxhimit të Cilësisë	Kryeauditues, Drejtorë Departamenti dhe Drejtorë të Përgjithshëm	03-04-12.2020
VI	Manuali i Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve	Departamentet e auditimit	07-28.12.2020

a. Trajnimet mbi manualët e auditimit:

- Në përmbushje të objektivave, si dhe mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Jashtëm të INTOSAI-t, ISSAI 100, Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit Administrativ të KLSH, në zbatim të Programit të Zhvillimit Profesional të KLSH për vitin 2020, miratuar me Vendim nr. 187, datë 31.12.2019, të gjithë audituesit gjatë vitit 2020, kanë ndjekur Programin e Trajnimit (online) “Mbi Manualët e Auditimit”, të përditësuar, sipas programit të miratuar. Trajnimi mbi secilin manual auditimi, u shtri në tre ditë, duke ju referuar fazave të auditimit, planifikimit, auditimit në terren dhe raportimit të auditimit.

b. Trajnim mbi implementimin e Udhëzuesit të Menaxhimit të Cilësisë:

- U realizua në bashkëpunim me Drejtorinë e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, trajnimi dy ditor, dedikuar implementimit të Udhëzuesit për menaxhimin e cilësisë”. Ky trajnim u moderua nga Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të cilësisë në KLSH z. Gjovalin Preçi, ku mori pjesë stafi drejtues, i cili është pjesë e zinxhirit të vlerësimit të standardeve dhe sigurimit të cilësisë së auditimeve në KLSH.
- Kryerja e këtij trajnimi kishte si prioritet, zbatimin e Plan veprimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së me nr. 1035, datë 16.10.2020, “Mbi zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Komisionit European për Shqipërinë, datë 06.10.2020”, Kapitulli 32 “Kontrolli financiar”, Rekomandimin nr. 3.1, ku është cilësuar, nevoja e për hartimin dhe zhvillimin e një plani specifik trajnimesh, i cili ka në fokus zbatimin e kërkesave të standardit të INTOSAI-t, ISSAI-140 “Kontrolli dhe Sigurimi i Cilësisë” dhe implementimin praktik të Udhëzuesit për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit në kontekstin e implementimit dokumenteve të rishikuara (Rregullore e Procedurave të Auditimit në KLSH, Manuali i Auditimit Financiar, Manuali i Auditimit Përputhshmërisë, Manuali i Auditimit Performancës, si dhe Manuali i Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve) dhe të miratuara në qershor 2020.

c. Trajnim i përbashkët me Ministrinë e Financave:

Në Strategjinë e KLSH-së 2018-2022, Kapitulli V “Fokusi strategjik i KLSH-së, qëllimet strategjike dhe objektivat për periudhën 2018-2022” janë përcaktuar tre qëllimet kryesore të cilat sintetizohen në vizionin e KLSH-së.

- Rritja e impaktit të punës audituese me fokus 6 E-të;
- Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse;

3. Përmirësimi i kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit.

Referuar qëllimit të tretë, pika 3.4. "Thëllimi dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucionet e tjera", por edhe faktit që hartimi i Strategjisë për Zhvillim e Kontrollit të Lartë të Shtetit, është mbështetur në *Moton e INTOSAI-t "Nga eksperiencat e përbashkëta, përfitojnë të gjithë"*, KLSH, konsideron bashkëpunimin me partnerët qeveritarë, në angazhime të përbashkëta dhe pse rolet janë të ndryshme, si një mjet për rritjen e efektivitetit të punës, pasi veprimtaritë e ndjekura bashkërisht sigurojnë impakt më të madh të auditimeve të tij.

Gjithashtu, në ligjin nr. 154/2014 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", është përcaktuar:

Neni 8 "Bashkëpunimi"

2. *Bashkëpunimi nënkupton anëtarësimin, pjesëmarrjen në formë të përshtatshme për auditimin, shkëmbimin e eksperiencave dhe kryerjen e trajnimeve të përbashkëta, ku në çdo rast Kontrolli i Lartë i Shtetit përfaqëson dhe mbron interesat e Republikës së Shqipërisë.*

Neni 16 "Vlerësimi i sistemeve të kontrollit dhe auditimit të brendshëm"

1 *K Kontrolli i Lartë i Shtetit, në ushtrim të kompetencave të tij, vlerëson funksionimin e përgjithshëm të sistemeve të kontrollit dhe auditimit të brendshëm në organet subjekte të auditimit, duke dhënë, sipas rastit, opinionet dhe rekomandimet e duhura.*

Në përmbushje të detyrave ligjore të cilësuara në nenin 8 dhe 16, të angazhimit të KLSH-së, për përmirësimin e mjedisit të kontrollit të brendshëm publik, në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis KLSH dhe ME, nënshkruar më datë 08.05.2012, por dhe në përmbushje të përcaktimeve të Kapitullit 32 të *Acquis communautaire*, u realizua **trajnim i përbashkët me Drejtorinë e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të fokusuar në çështjet e menaxhimit financiar dhe sistemin e kontrollit të brendshëm në sektorin publik, si një element i rëndësishëm që ndikon në, shkëmbimin e eksperiencave, përfitimin e ndërsjellë, si dhe rritjen e efektivitetit të punës audituese, me impakt në performancën e njësive të qeverisjes së përgjithshme.**

Kjo në përmbushje edhe të objektivave specifike të Strategjisë Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022, ku është evidentuar se forcimi i MFK-së, mbetet ende në prioritet për vitet e ardhshme, ku problematik vazhdon të mbetet zbatimi i plotë i kërkesave të legjislacionit të MFK-së.

Sa më sipër, KLSH në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, u zhvilluan dy tema trajnime, të fokusuara në çështjet e menaxhimit financiar, sistemin e kontrollit të brendshëm dhe Auditin e Brendshëm në sektorin publik.

Dy ditët e trajnimit u moderuan nga:

- Znj. Albana Gjinopulli, Drejtore e Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik;
- Znj. Drinalda Ajazi, Specialiste në Drejtorinë e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm në MFE, për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
- Nga KLSH, morën pjesë në këtë trajnim online, nga dy auditues për çdo departament, gjithsej 14 auditues.

d. Shkëmbimi i përvojave me shoqërinë civile, **ëorkshop me Organizatën Jofitimprurëse "Qëndresa Qytetare"**, zhvilluar në KLSH në datë 30.10.2020, me temë "Ndërveprimi dhe shkëmbimi i përvojave midis audituesve të KLSH-së dhe analistëve të "Qëndresës Qytetare". Nga audituesit e Departamentit të Auditimit të Performancës, u prezantuan 5 auditime të me impakt social si më poshtë:

- Efektiviteti i kushteve për zhvillimin strategjik të turizmit;
- Cilësia e godinave të shkollave para universitare;

- Cilësia e ajrit;
- Siguria dhe cilësia e barnave, në rrjetin e hapur farmaceutik dhe shërbimin spitalor;
- Efektiviteti i kasave fiskale, në rritjen e të ardhurave tatimore.

Të dhëna mbi realizimin e trajnimeve, sipas Programit të trajnimeve nr. 724/1, datë 09.11.2020

Trajnimet e brendshme në KLSH:

1. Trajnim mbi Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë;
2. Trajnim mbi Manualin e Auditimit të Performancës;
3. Trajnim mbi Manualin e Auditimit Financiar;
4. Trajnim mbi Manualin e Zbatimit të Rekomandimeve;
5. Trajnim mbi Udhëzuesin e Menaxhimit të Cilësisë;

Trajnime të përbashkëta:

1. Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm në sektorin publik;
2. Me Organizatën Jofitimprurëse “Qëndresa Qytetare”.

Për sa ju përket trajnimeve jashtë vendit, si rezultat i Pandemisë Covid-19, në krahasim me periudhat e mëparshme pati një rënie të aktiviteteve. Kështu, gjatë vitit 2020, janë zhvilluar jashtë vendit 20 aktivitete, si ëorkshope, konferenca, vizita studimore, etj.

IV. Suporti nga IT dhe reflektim i ndryshimeve në SIMMPA/ REVZONE

Në funksion të ndjekjes dhe pasqyrit të trajnimeve online si mundësi alternative e ndarjes dhe shkëmbimit të ideve, u modifikuan dhe përmirësuan opsionet e reja programore si vijon, në:

1. Ëeb-faqen e KLSH-së, nëpërmjet shtimit në panelin “Informacione”, tek grupi “Trajnime”, zërin “Trajnimet Online”.
2. Programin e Sistemit të Informacionit për Menaxhimin dhe Mbështetjen e Proceseve të Auditimit (SIMMPA / RevZone), të dritares/ opsionit “Trajnimet Online”.
3. Hartimit të udhëzimit mbi përdorimin e manualit të Trajnimeve (nga Sektori IT)
4. Hedhja në Revzonë e ecurisë së ndjekjes së trajnimeve të zhvilluara nga çdo auditues (Matrica e ndjekjes së ecurisë), Informacioni i plotë mbi trajnimet (Raport Progreset javore dhe të përditësuara); postimi i fondit të testeve, pyetjeve, ushtrimeve dhe rasteve studimore, etj.

KLSH ne vijim me burimet financiare disponibel do të vazhdojë përpjekjet institucionale të cilat synojnë modernizimin dhe reformimin e institucionit me qëllim që të reflektojmë tiparet dhe standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit INTOSAI dhe fokusimin e veprimtarisë audituese me impakt, forcimin e llogaridhënjes publike, të integritetit, transparencës institucionale.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
(Në mungesë dhe me urdhër)



ne 000/leke

Sekretari i Përgjithshëm	Emri	Gjovalin Preci
	Firma	
	Data	26/02/2021
		

Sekretari i Përgjithshëm


Giovalin Preci

26/02/2021

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit Programi	Kontrolli i Lartë i Shtetit						Kodi i Grupit	
	Programi Veprimtari Audituese e KLSH						Kodi i Programit	
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2019	(2) PBA Plan Viti 2020	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv 12- Mujori	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	256,179	267,000	274,000	270,000	270,000	257,973	-12,027
601	Sigurime Shoqërore	39,926	42,000	42,000	42,000	42,000	40,143	-1,857
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	79,463	88,850	80,850	71,850	71,850	50,822	-21,028
603	Subvencione							0
604	Transferta Korente të Brendshme							0
605	Transferta Korente të Huaja	117	150	150	150	150	118	-32
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,133	600	600	2,276	2,276	2,160	-116
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	376,818	398,000	397,600	386,276	386,276	351,217	-35,060
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	1,836					0
231	Kapitale të Trupëzuara	190	14,800	29,000	18,000	18,000	13,764	-4,236
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	190	16,636	29,000	18,000	18,000	13,764	-4,236
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara		18,036	18,036	18,036	18,036		-18,036
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	18,036	18,036	18,036	18,036	0	-18,036
Totali	Shpenzime Kapitale	190	34,672	47,036	36,036	36,036	13,764	-22,272
	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti						0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		377,008	432,672	444,636	422,312	422,312	364,980	-57,332

Përgjegjes Sektori Finance	Alketa Kalleshi	Emri	Sekretari i Përgjithshëm
		Firma	
	Data 26/02/2021	Data	



ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit		Kodi i Grupit	1024001
Programi		Kodi i Programit	1120

	ne 000/teke				I			II			Shpenzime t	III			IV	Luhatjet ne Koston per Njesi	
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (sipas vitit 2019)	Shpenzimet (sipas vitit 2019)	Kosto per Njesi (sipas vitit 2019)	Sasia (sipas planit te vitit 2020)	Shpenzimet (sipas planit te vitit 2020)12-Mujori i I	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Saspazime t (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike (ne fund te vitet korent)12- mujori	Shpenzimet (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III
A	Auditime te kryera	numer	140	376,819	2,692	160	444,636	2,779	143	422,312	2,953	73	351,216	4,811	2,123	2,032	1,858
B	Blerje paisje kompjuterike	numer	0	0	0	49	16,880	344	127	15,580	123	127	13,493	106	105	-238	-16
C	Blerje paisje zyre	numer	19	190	10	20	520	26	25	520	21	22	271	12	2	-14	-8
D	Blerje Automjete	numer	0	0	0	3	9,700	3,233	0	0	0	0	0	0	0	0	0
G	Kosto Lokale	numer				3	1,900	633	3	1,900	633	0	0		0		
H																	

Pergjegjesi Sektori Finance	Emri	<i>Alena Kalleshi</i>	Sekretari i Pergjithshem	Emri	
	Firma	<i>[Signature]</i>		Firma	
	Data	26/02/2021		Data	26/02/2021



Kodi i Programit	1024001	Emertimi i programit:	Veprimtari Auditueses e Kontrollit te Larte te Shtetit					Komente	
Qellimi 1	" Ushtrimi i veprimtarise audituese ne nje linje me standartet nderkombetare te auditimit mbi perdorimin me efektivitete, eficence dhe ekonomicitet te fondeve publike ne funksion te rritjes se pergjegjshmerise se menaxhimit te financave e pasurise publike duke sjelle vlere te shtuar per shoqerine dhe ndryshim ne jeten e qytetareve"								
			**Treguesit e performancës/Produktet:						
	Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances**/Produktit	Niveli faktik i vitit 2019	Niveli i planifikuar ne vitin 2020	Niveli i rishikuar ne vitin 2020	Niveli faktik ne fund12- mujorit 2020	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1.	"Mbulimi me auditime financiare perputhshmerie dhe performance i njesive te sektorit publik nepermjet konsolidimit te auditimeve te perputhshmerise rritjes se auditimeve financiare dhe te performances ne nje linje me Standartet Nderkombetare te Auditimit ISSAI"	A	Auditime te kryera	140	160	143	73	51%	Perdorimi i fondeve auditore ne funksion te modernizimit institucional ne nje linje me standartet nderkombetare INTOSAI dhe praktikat me te mira, ngrijen e kapaciteteve audituese, ushtrimi i veprimtarise audituese ne permishje te detyrimit ligjor kushtetues sipas programit te miratuar nga Kryetari i KLSH-se, si dhe garantimi i auditimeve me cilësi të lartë dhe efektivitet. Kryerja e Auditimeve të përputhshmërisë, të certifikimit të pasqyrave financiare, të teknologjisë së informacionit dhe të performancës konfor
Objektivi 1.1	Ofrimi i kushteve cilësore të punës për zhvillimin e aktivitetit auditues të KLSH-së nëpërmjet investimit për ngrijen e godinës dhe përmirësimin e infrastrukturës akomoduese me paisje dhe orëndi të nevojshme, në funksion të ushtrimit normal të veprimtarisë institucionale.	A	Blerje paisje kompjuterike		49	127	127	100%	
		B	Blerje paisje zyre	19	20	25	22	88%	
		c	Blerje Automjete		3	0	0		
		d							
		e							
		A							

Përgjegjës Sektori Financë	Emri	Aliqeta Kallësthi 	Sekretari i Përgjithshëm 	Emri Firma Data	Gjendja e Prerit 

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Projektet me financim te brendshem (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti 2020 Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2020	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (12-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M240010	Paisje te ndryshme zyre	520	2020	2020		520	271	271	0	
M240009	Blerje paisje kompjuterike	15580	2020	2020		15580	13492.8	13492.8	0	
M240002	Blerje automjete						0	0	0	
M240012	kosto Lokale	2900	2020	2021		1900	0	0	0	

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Grant/ Kredi	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2020	REALIZIMI për periudhën e raportimit (12-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
19AA401	Forcimi i rolit të Auditimit të Jashtëm në mbikqyrjen e partneritetit publik-privat në Shqipëri	Grant/	26889	2020	2021	0	18036	0	0	0	

Përgjegjës Sektori Finance	Emri	Alketa Kalleshi	Sekretari i Përgjithshëm	Emri	Gjergjini Preci
	Firma			Firma	
	Data	26/02/2021		Data	26/02/2021

